



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr.47/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit “P...”, sh.p.k., me adresë në Magjistralen Prishtinë – Fushë Kosovë, kundër të paditurit “P.P.....” sh.p.k. me adresë në lagjen Bregu i Diellit..., nr.1, Prishtinë, me objekt kontesti mos përmbushje e kontratës, jashtë seancës, me datë 09.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit “P...”, sh.p.k., me numër KE.nr.47/22 (C.nr.960/15 e datës 21.04.2015, 2019:245213), me objekt kontesti mos përmbushje e kontratës, ndaj të paditurit “P.P.....” sh.p.k.
- II. Shpenzimet e procedurës i bart secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi P...”, sh.p.k., me adresë në Magjistralen Prishtinë – Fushë Kosovë, me datën 05.01.2017, ka parashtruar padi për kompensim të dëmit, kundër të paditurit “P.P.....” sh.p.k., me adresë në lagjen Bregu i Diellit..., nr.1, Prishtinë, për neglizhencë dhe mos përmbushje të detyrimeve.

Paditës P...”, sh.p.k., me datën 28.04.2022, me anë të parashtrësës, e ka njoftuar Gjykatën se tërheq padinë për lëndën C.nr.960/15, të datës 21.04.2015, kundër të paditurit “P.P.....” sh.p.k., për shkak se çështja është zgjidhur në procedurën përbarimore në të cilën paditësi ka qenë në cilësinë e debitorit, ndërsa i padituri në cilësinë e kreditorit dhe paditësi i ka përmbushur obligimet sipas Aktvendimit PPP.nr.8/2017, të datës 11.05.2018, të Gjykatës Themelore në

Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm dhe pasi që çështja juridike ka përfunduar, paditësi e tërheq padinë e parashtruar.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së paditësit, në kuptim të nenit 261 dhe 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 47/22, datë 09.09.2022.

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.